



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 879/1 Prot.

Tiranë, më 26.07.2023

V E N D I M

Nr. 140, Datë 26.07.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 198, datë 15.12.2022¹, e bërë nga Urdhri Profesional Hidroteknik² kundër Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), Komisionit të Posaçëm për Dhënien e Licencave Profesionale, pranë MIE dhe Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, “gjendjes shoqërore” dhe “çdo shkak tjetër³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me shkresën nr. 02, datë 05.01.2023, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Urdhri Profesional Hidroteknik është enti publik kombëtar vetërregullues, i vetëdrejtuar dhe i vetëfinancuar, i përbërë nga individë që kanë kualifikim profesional të veçantë me titull “Inxhinier Hidroteknik”, të cilët zotërojnë dokumentin zyrtar “Diplomë”, të Republikës së Shqipërisë dhe që përfaqëson interesat e tyre profesionale në nivel bashkëpunimi institucional. Urdhri Profesional ka fituar personalitet juridik dhe është regjistruar dhe identifikohet me NIPT-in L71828451I. Kjo e drejtë është dhënë me ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe tek VKM nr. 649, datë 14.09.2011 “Për përcaktimin e listës së specialiteteve,

¹ Me shkresën nr. 1601/1, datë 23.12.2022, Komisioneri ka kërkuar shpjegime dhe plotësim dokumentacioni nga ankuesi. Urdhri Profesional Hidroteknik, ka kthyer përgjigje me e-mail-in datë 05.01.2023.

² Referuar Çertifikatës së Regjistrimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Urdhri Profesional Hidroteknik është i pajisur me numër identifikimi (NIPT/SSN) L71828451I.

³ Pa përcaktuar një cilësi të grupit apo shkak.

nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”, i ndryshuar. Urdhëri ka fituar personalitet juridik që nga çasti i aktit të krijimit që është nënshkruar me datë 16.06.2017 në Dhomën e Noterisë Tiranë dhe në vijim regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme Tatimore të RSH-së, aktiv që prej datës 28.06.2017. Urdhri Profesional Hidroteknik, në zbatim të ligjit 10171/2009 “Për Profesionet e Rregulluara në RSH”, i ndryshuar, rishikoi dhe analizoi të gjithë kuadrin ligjor rregullator dhe gjendjen aktuale të aktiviteteve të disa strukturave të varësisë së MIE-s dhe të MAS-it dhe konstatoi që gjendet përpara faktit të diskriminimit strukturor. Komisioni i dhënies së licensave profesionale në MIE (për Inxhinierin Hidroteknik), pajis me licenca, duke i dhënë të drejtën e ushtrimit të profesionit në kundërshtim me ligjin. Neni 12 i ligjit 10171/2009, i ndryshuar, përcakton se: “Çdo profesionist, për të fituar të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, regjistrohet në urdhrin profesional përkatës”. Përveç se është në kundërshtim me këtë nen, kjo veprimtari bie në kundërshtim edhe në tërësinë e Kreut II “Kushtet dhe kriteret për ushtrimin e profesionit të rregulluar”, pasi prodhon licenca profesionale për ata individë, pa qenë minimalisht të pajisur me titullin përkatës Inxhinier Hidroteknik. Pikërisht këta persona nxisin urrejtje kundrejt institucionit publik përfaqësues, (njerëz që kryejnë këtë aktivitet në drejtorinë e licensave dhe komisionin e licensave, që nuk kanë përfaqësim ligjor, por njerëz të pa identifikuar jashtë strukturave të institucioneve të shtetit. Persona të tillë duhet të jenë publik dhe të deklaruar për minimalisht profesionin e tyre dhe kë përfaqësojnë) dhe ndihmojnë një grup personash (jo me titullin Inxhinier Hidroteknik), me qëllim diskriminimin e një grupi tjetër (me titull Inxhinier Hidroteknik). Si pasojë e këtij veprimi ose mosveprimi të MIE-es dhe MAS-it, kanë çenuar sigurinë shoqërore dhe të drejtat e personave jo vetëm të Inxhinierëve Hidroteknik me titull, por edhe të çdo personi i cili merr shërbim nga këto persona të pacertifikuar. Ankuesi informon se kërkon zbatimin e ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në RSH” i ndryshuar, dhe VKM-së 649/2011, nga institucionet të cilat diskriminojnë me strukturat e tyre jolegjitime një kategori siç janë Inxhinierët Hidroteknik”.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të shumëfishtë, të një grupi njerëzish, profesionistë të lirë, të pajisur me titull Inxhinier Hidroteknik të përfaqësuar nga Urdhri Profesional Hidroteknik, për shkak të gjendjes arsimore, shoqërore dhe çdo shkak tjetër, për arsye si më poshtë:

1. Të mos kryerjes së praktikës profesionale, sipas nenit 11 të ligjit 10171/2009, i ndryshuar, nga ana e MIE-s (privohet e drejta e edukimit dhe e certifikimit duke çenuar garancinë e profesionistit për të ardhmen në kryerjen e shërbimit, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të papaguara).

Në referim të kësaj pike, MIE të marrë masa për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur, duke bashkëpunuar me Urdhrin Profesional Hidroteknik me qëllim zbatimin e ligjit, për realizimin e Praktikës Profesionale, për Kandidatët për titullin Inxhinier Hidroteknik.

2. Të lejimit të Ushtrimit të Profesionit, duke licencuar njerëz Jo Profesionistë në kundërshtim me ligjin 10171/2009, i ndryshuar, neni 6, 8, 9 dhe 12, nga ana e MIE si dhe nga ana e Komisionit të Dhënies së Licencave; (pasi pajis me licencë pa pasur Titull duke pasqyruar në këtë dokument licencë “Titullin Inxhinier”).

Në referim të kësaj pike, MIE dhe Komisioni i Dhënies së Licencave Profesionale për dhënien e licencave për Inxhinierët Hidroteknik, të marrë masa për të rivendosur të drejtën e shkelur, duke ndërprerë dhënien e licencave për grupin “Inxhinier Hidroteknik”, si dhe të revokojë të gjitha licencat për ata njerëz që nuk kanë titullin Inxhinier Hidroteknik.

3. Të mosrealizimit të Provimit të Shtetit, sipas ligjit 10171/2009, i ndryshuar, neni 9, nga ana e MIE dhe MAS, si edhe nga ana e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor; *(këto institucione kanë për detyrë të organizojnë Provimin e Shtetit që prej vitit 2009, nuk është organizuar, dmth të gjithë ata njerëz, që kanë përfunduar edukimin e lartë në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, kursi Hidroteknik nuk kanë pasur mundësi të pajisen me Titullin Inxhinier Hidroteknik).*

Në referim të kësaj pike, MAS, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe MIE, të marrë masa duke:

- a) MAS detyrohet që të organizojë Provimin e Shtetit për kategorinë “Inxhinier Hidroteknik”;
- b) MAS, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe MIE detyrohen që brenda 30 ditëve të hartojnë dhe të pasqyrojnë urdhrin “Për ngritjen e Komisionit të Provimit të Shtetit”, si dhe ta publikojnë në Qendrën e Publikimeve Zyrtare.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD përcaktohet se: “*“Organizatata me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”*”.

Urdhri Profesional Hidroteknik, është person juridik i regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve⁴ me numër identifikimi (NIPT/SSN): L7182845II, i cili përfaqëson⁵ interesat e përbashkëta, të profesionistëve me kualifikim profesional me titull “Inxhinier Hidroteknik”, të cilët zotërojnë dokumentin zyrtar “Diplomë” dhe që vetëfinancohet dhe ka në objekt të veprimtarisë së tij përmirësimin dhe forcimin e autoritetit publik të profesionit të Inxhinierit Hidroteknik të cilët kryejnë aktivitetin vetërregullues, të cilat lidhen me mbrojtjen e interesit publik, të sigurisë, të shëndetit, të zhvillimit ekonomik, duke respektuar parimin e krijimtarisë dhe shqyrtimit të pavarur, si dhe të autonomisë së profesionistëve.

⁴ Referuar Çertifikatës së Regjistrimit, numër serial: 10150273512, datë 28.06.2017 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë.

⁵ Referuar nenit 1 dhe 2 të Statut Rregullores së Urdhrit Profesional Hidroteknikë në Republikën e Shqipërisë, datë 16.06.2017.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së palës ankuese dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar se pala ankuese legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 97, datë 17.01.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga institucionet, për ankesën e bërë nga Urdhri Profesional Hidroteknik.

Me shkresën nr. 629/1, datë 24.01.2023, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “*Ligji nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ndër të tjera ka për qëllim përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e disa profesioneve të rëndësishme, të cilat lidhen me mbrojtjen e interesit publik, të sigurisë publike dhe të shëndetit, duke respektuar parimin e shqyrtimit të pavarur dhe autonomisë e profesionistëve. Gjithashtu, në nenin 4 pika a) dhe f) “Përkufizime” përcaktohet se: “Profesion i rregulluar është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta”. “Urdhri Profesional është enti publik kombëtar, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesioneve në një fushë të caktuar dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut”. Neni 15, pika 3 “Urdhri profesional” përcakton se: “Organizimi dhe funksionimi i urdhrit profesional bëhet me ligj të veçantë”.*

Ndërkohë që VKM nr. 649, datë 14.09.2011, “Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”, të ndryshuar, në shtojcën I, ka të përcaktuar edhe profesionin e Inxhinierit Hidroteknik, si profesion i rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

Sa më sipër, lidhur me pretendimin për diskriminim të subjektit ankues, se Komisioni i dhënies së licencave profesionale në MIE bie në kundërshtim me ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, pasi: “Çdo profesionist, për të fituar të drejtën e profesionit të rregulluar, regjistrohet në urdhrin profesional përkatës”, është i pabazuar pasi që një Urdhër Profesional të ushtrojë funksionin si i tillë, duhet së pari të jetë krijuar konform rregullave ligjore në fuqi. Në kushtet kur aktualisht Urdhri Profesional Hidroteknik nuk është i miratuar me ligj, këto kërkesa nuk gjenden të bazuara”.

Me shkresën nr. 332/3, datë 31.01.2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 332/2, datë 25.01.2023, me lëndë “Kërkohej informacion dhe dokumentacion”, drejtuar Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ka kërkuar vënien në dispozicion të çdo informacioni dhe dokumentacioni që disponon lidhur me këtë rast, referuar komunikimeve zyrtare që Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) ka pasur me Urdhrin Profesional të Hidroteknikeve.

Nga informacioni i përcjellë, rezulton se QSHA me shkresën nr. 1060/1, datë 01.03.2022, me lëndë “Kthim përgjigje”, drejtuar Urdhrit Profesional Hidroteknik, i bën me dije se: “...Lidhur me organizimin dhe zhvillimin e provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të Inxhinierit, duhet të ndërmerren hapat e nevojshëm ligjorë, të parashikuar në Rregulloren “Për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 365, datë 28.12.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Dëshirojmë t’u sigurojmë se QSHA është maksimalisht e angazhuar për të ofruar bashkëpunimin e saj, lidhur me realizimin e procedurave për organizimin dhe zhvillimin e provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të Inxhinierit”.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se shkresa juaj me nr. 97, datë 17.01.2023, me lëndë “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, i është njoftuar edhe Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH)”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 424, datë 20.03.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 28.03.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Subjekti ankues, nëpërmjet telefonit dhe me e-mail-in datë 29.03.2023, ka njoftuar se nuk mund të marrë pjesë në seancë, pasi është thirrur në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi prezantohej projektligji “Për urdhrin e inxhinierit hidroteknik në Republikën e Shqipërisë”.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 498, datë 12.04.2023, njoftoi palët për shtyrjen e seancës dëgjimore, për tu zhvilluar në datë 26.04.2023.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: Urdhri Profesional Hidroteknik, i përfaqësuar nga z. E.N dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, znj. M.R, përfaqësueses së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë znj. I.H, ndërsa nuk u paraqitën në seancë përfaqësues nga Komisioni i Posaçëm për Dhënien e Licencave Profesionale, pranë MIE dhe Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në dhe dorëzoi parashtrime me shkrim me shkresën nr. 33, datë 26.04.2023.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i MIE i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe informoi⁶ se: *“Komisioni i posaçëm i dhënies së licencave ushtron veprimtarinë në kuadër të legjislacionit në fuqi dhe si i tillë është pjesë e fushës së përgjegjësisë së MIE-s”*.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i MAS i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe informoi⁷ se: *“MAS nëpërmjet Qendrës së Shërbimeve Arsimore ka kompetencë vetëm pjesën teknike të zhvillimit të provimeve të shtetit dhe ngritjen e Komisionit të provimit të shtetit, që në këtë rast ka 5 anëtarë (2 përfaqësues, anëtarë të universiteteve, 1 përfaqësues, anëtar i Urdhrit Profesional, 1 përfaqësues, anëtar i autoritetit kompetent dhe 1 përfaqësues i caktuar nga MAS). Këshilli i Arsimit të lartë dhe Kërkimit Shkencor është një organ këshillimor i ngritur pranë MAS që mblidhet për çështje të caktuara dhe nuk ka kompetenca përse i përket provimit të shtetit për inxhinierët. KALKSH ka të drejtë të propozojë 2 anëtarë, sipas nenit 10 të ligjit 10171/2009 dhe nuk ka kompetencë vendimmarrëse”*.

Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesja e MIE, me e-mail-in datë 08.05.2023, informoi Komisionerin si më poshtë: *“Komisioni i posaçëm i dhënies së licencave në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, trajton materialin e përgatitur nga sekretaria teknike në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesit (diploma master ose diplomë e nivelit të dytë, cv dhe dokumentacion teknik justifikues) dhe vendos miratimin ose jo të licencave në bazë të VKM nr. 943, datë 28.12.20216.*

Bazuar në të dhënat e rregjistrit profesional të individëve dhe shoqërive të licencuara në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, bashkëlidhur ju dërgojmë listën e inxhinierëve hidroteknik të licencuar në periudhën Janar-Dhjetor 2022”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

⁶ Referuar deklaratimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 48.00 e në vijim.

⁷ Referuar deklaratimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 51.20 e në vijim.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e subjektit për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32/2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: “*1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë*”.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b⁸, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira

⁸ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: “*Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...*”

- apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
 - dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me propozim të Këshillit të Ministrave ka miratuar Ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në nenin 2, pika a) ligji ka përcaktuar se: “Qëllimi i këtij ligji është: a) përcaktimi i kriterëve për ushtrimin e disa profesioneve të rëndësishme, të cilat lidhen me mbrojtjen e interesit publik, të sigurisë publike dhe të shëndetit, duke respektuar parimin e shqyrtimit të pavarur dhe autonomisë e profesionistëve”.

Në nenin 4 “Përkufizime” përcaktohet se: “a) “Profesion i rregulluar” është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. c) “Dokument zyrtar i formimit apo kualifikimit profesional” është diploma, certifikata ose dëftesa, lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, që certifikon përfundimin e suksesshëm të një formimi apo kualifikimi profesional, të zhvilluar brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. ç) “Autoritet kompetent” është çdo autoritet, i ngarkuar me akt ligjor apo nënligjor, si përgjegjës e rregullator për një apo më shumë profesione të rregulluara, për njohjen e së drejtës së ushtrimit të tyre, për pranimin e aplikimeve, të deklarimeve dhe marrjen e vendimeve. f) “Urdhri Profesional” është enti publik kombëtar, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesioneve në një fushë të caktuar dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut”.

Në neni 5, germa f) përcaktohet se profesion i rregulluar në RSH, është dhe profesioni i inxhinierit.

Në nenin 6, pika 2 përcaktohet se: “Profesioni ushtrohet si person fizik ose juridik, me cilësinë e të vetëpunësuarit ose të të punësuarit, sipas kërkesave të përcaktuara nga UP-ja përkatëse”.

Në nenin 8, pika 1 të ligjit, përcaktohet se: “1. Për të fituar të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, çdo kandidat duhet: a) të kryejë praktikën profesionale; b) të kryejë provimin e shtetit; c) të regjistrohet në UP-në përkatëse”.

Në nenin 10, përcaktohet se: “1. Provimi i shtetit organizohet dhe zhvillohet nga ministria që mbulon fushën e arsimit, në bashkëpunim me autoritetin kompetent përkatës. 2. Me urdhër të ministrit që mbulon fushën e arsimit dhe të autoritetit kompetent përkatës ngrihet Komisioni i Provimit të Shtetit, me këtë përbërje:

- a. një përfaqësues i caktuar nga ministri që mbulon fushën e arsimit;
- b. një përfaqësues i autoritetit kompetent;
- c. një përfaqësues, anëtar i UP-së përkatëse;
- ç) dy përfaqësues nga personeli akademik i universiteteve, të akredituara për programin përkatës të studimit të profesionit të rregulluar, të cilët kanë titullin shkencor “Profesor” dhe kanë, të paktën, 10 vjet përvojë pune në institucionet e arsimit të lartë.

3. Anëtarët e përcaktuar në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 2 të këtij neni emërohen sipas mënyrës së mëposhtme:

- a. UP-ja i propozon autoritetit kompetent të paktën dy kandidatura, prej të cilave zgjidhet përfaqësuesi i përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij neni;
- b. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës i propozon ministrit që mbulon fushën e arsimit, të paktën, katër kandidatura, prej të cilave përzgjidhen dy përfaqësuesit e përcaktuar në shkronjën “ç” të pikës 2 të këtij neni”.

Në nenin 11, “Praktika profesionale” përcaktohet se: “1. Praktika profesionale synon përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit, mënyrat e së cilës përcaktohen nga autoriteti kompetent, me propozimin e UP-së përkatëse. 3. Autoriteti kompetent, në bashkëpunim me UP-në, kur ka një të tillë, bën regjistrimin e kandidatëve për kryerjen e praktikës profesionale dhe siguron që praktika të kryhet nën drejtimin e një profesionisti, i cili e ushtron profesionin prej jo më pak se tre vjetësh dhe jep garanci të mjaftueshme për përgatitjen teoriko-praktike të praktikantit. Në përfundim të praktikës profesionale, kandidati i nënshtrohet “Vlerësimit për aftësimin praktik”, të organizuar dhe të zhvilluar nga autoriteti kompetent, nëpërmjet strukturave të veta. Praktika profesionale konsiderohet e kryer vetëm pas vlerësimit pozitiv të aftësimin praktik. Modalitetet e organizimit të vlerësimit të aftësimin praktik përcaktohen në rregulloren e praktikës profesionale, që miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit që mbulon fushën përkatëse dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës”.

Neni 12 i ligjit, përcakton se: “Çdo profesionist, për të fituar të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, regjistrohet në urdhrin profesional përkatës”.

Në neni 15, pika 3 përcaktohet se: “Organizimi dhe funksionimi i urdhrin profesional bëhet me ligj të veçantë”.

Referuar ligjit të sipërcituar, rezulton se për të fituar të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, në rastin në shqyrtim të inxhinierit hidroteknik⁹ çdo kandidat duhet, të kryejë praktikën profesionale, provimin e shtetit dhe të regjistrohet në Urdhrin Profesional përkatës.

Gjithashtu, referuar nenit 15/3 të ligjit, rezulton se organizimi dhe funksionimi i urdhrin profesional (inxhinier hidroteknik) bëhet me ligj të veçantë.

9 Në VKM nr. 649, datë 14.09.2011, “Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”, të ndryshuar, në shtojcën 1, ka të përcaktuar edhe profesionin e Inxhinierit Hidroteknik, si profesion i rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

Në VKM nr. 111, datë 02.03.2022 *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësishë shtetërore të MIE”*, përcaktohet se: *“2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin e zbatimit e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës e të transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, të shfrytëzimit të burimeve energjitike e minerare, si dhe në sektorin e industrisë”*.

Bazuar në këtë mision të MIE-s, për hartimin e politikës së përgjithshme në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, që më përpara mbulohej nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, MIE¹⁰ ka publikuar për konsultim publik¹¹ projektligjin *“Për Urdhrin Profesional të inxhinierëve”*.

Njëkohësisht dhe në Kuvendin e Shqipërisë janë dorëzuar dy nisma, nr. 493, datë 06.02.2020 dhe nr. 2389, datë 13.10.2021, nga deputetë të Kuvendit, për shqyrtim dhe miratim të projektligjit *“Për Urdhrin i Inxhinierit Hidroteknik në Republikën e Shqipërisë”*.

Aktualisht në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të Kuvendit është prezantuar dhe po shqyrtohet projektligji *“Për Urdhrin Profesional të inxhinierëve”*, dhe referuar procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të datës 22.06.2022 dhe 06.07.2022, rezulton se në këto mbledhje kanë qenë të ftuar për të dhënë mendimet e tyre dhe përfaqësues nga shoqatat e inxhinierëve, të cilët kanë dhënë konsideratat e tyre përse i përket projektligjit.

Përse më sipër, Komisioneri vlerëson se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor¹², për sa kohë që projektligji *“Për urdhrin profesional të inxhinierëve”*, nuk është i miratuar nga Kuvendi, janë në pamundësi objektive për të zbatuar përcaktimet e parashikuara sipas ligjit nr. 10171/2009 *“Për profesionet e rregulluara në RSH”*, i ndryshuar, lidhur me kryerjen e praktikës profesionale, organizimit të provimit të shtetit dhe ngritjes dhe funksionimit të urdhrin profesional të inxhinierit.

- *Lidhur me pretendimin e ankuesit për licencimin e personave pa pasur titullin inxhinier, nga ana e Komisionit të Posaçëm për Dhënie e Licencave Profesionale, pranë MIE-s.*

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr 759, datë 12.11.2014 *“Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”*, i ndryshuar, ka vendosur që çdo individ apo person juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse dhe të regjistrohet në regjistrat profesionalë të subjekteve të licencuara në këto fusha, bazuar në rregulloren bashkëlidhur këtij vendimi.

¹⁰ <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Projektligji-Per-Urdhrin-Profesional-t-Inxhinierve.doc>

¹¹ <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/442>

¹² Referuar nenit 8/1 të ligjit 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”*, përcaktohet se: *“KALKSH është organ këshillimor për politikën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, pranë ministrit përgjegjës për arsimin”*.

Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar përbërja e Komisionit, në të cilën parashikohet se: *“Krijimin e komisionit, si strukturë e posaçme administrative, që ka autoritetin e vetëm për dhënien, ndryshimin apo revokimin e licencave profesionale të individëve apo subjekteve juridike, si dhe vendosjen e penaliteteve për veprimtari në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, i cili të ketë në përbërje:*

- një përfaqësues nga Kryeministria, i cili të jetë kryetar;
- dy përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- një përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës;
- një përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë;
- një përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës;
- një përfaqësues nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, i Universitetit Politeknik të Tiranës.
- një përfaqësues nga Shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë;
- një përfaqësues nga Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë;
- një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;
- një përfaqësues nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha.

..... *Detyrën e sekretariatit teknik të komisionit e ushtron struktura përkatëse për licencimin pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit”.*

Në Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, të miratuar me VKM nr 759, datë 12.11.2014, përcaktohen rregullat e funksionimit të komisionit dhe kushtet për pajisje me licencë profesionale.

Në nenin 22 të kësaj Rregulloreje përcaktohen kushtet paraprake për licencë profesionale individuale, të cilat janë: *“1. Për studim e projektim.*

- a. *Të disponojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshijë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilet përkatëse, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;*
- b) *Të ketë vite eksperiencë në projektim, në institucione publike projektuese, shoqëri studimi e projektimi, persona fizikë që ushtrojnë veprimtari profesionale në studim e projektim, ose institucione të arsimit të lartë.*

2. *Për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim:*

- a. *Të disponojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë, në profilet përkatëse, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;*

b. Të ketë të paktën 15 vjet eksperiencë në studime e projekte, apo zbatimin në ndërtim, në profesionin përkatës;

c. Të mos jetë drejtues teknik ose i punësuar, në shoqëri për zbatimin në ndërtim.

Kushtet e mësipërme paraprahe, vlejnë dhe për individët e huaj, që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale”.

Në nenin 26 të kësaj Rregulloreje përcaktohet se: *“1. Aplikimi për pajisje me licencë individuale për herë të parë, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprahe të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:*

a) Kërkesën e individit, ku të përcaktohen të paktën gjeneralitetet, adresa e plotë e individit dhe kategoritë, sipas zërave të punimeve, me të cilat individit kërkon të licencohet;

b) Kartën e identitetit;

c) Diplomën që zotëron;

ç) CV e individit, ku pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës;

d) Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përshirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën.

dh) Vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6).

e) Në rastet kur personi kërkon të pajiset edhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij, në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri, sipas formatit 6/2 të lidhjes nr.6).

ë) Dy fotografi për dokument, të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit).

f) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1)”.

Në nenin 42 të kësaj Rregulloreje përcaktohet se: *“Ankimi;*

1) Për çdo vendim të Komisionit, individët apo përfaqësuesit e shoqërive, kanë të drejtën e ankimit tek Ministri i Zhvillimit Urban, brenda 30 ditëve kalendarike, nga data e njoftimit apo publikimit.

2) Ministri i Zhvillimit Urban, pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos, brenda 15 ditëve kalendarike:

a. Lënien në fuqi të vendimit të marrë nga Komisioni.

- b. *Kthimin për rishqyrtim, në Komision, të vendimit të marrë.*
- c. *Ndaj vendimit të Ministrisë apo vendimit përfundimtar të komisionit, çdo subjekt, ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente administrative, brenda 45 ditëve kalendarike”.*

Referuar pretendimit të subjektit ankues dhe legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues megjithëse ka ngritur pretendime kundrejt Komisionit të Posaçëm për Dhënien e Licencave Profesionale, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit prova dhe fakte të shkeljeve të pretenduara nga ana e Komisionit¹³, apo ndonjë shkresë që të ishte ankuar tek Ministri përgjegjës, për shkelje të procedurave të licencimit. Të gjitha pretendimet e subjektit ankues kundrejt Komisionit, janë të karakterit deklarativ dhe nuk mbështeten në prova konkrete.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht: “1. *Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:*

- a) *duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) *duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjekteve ndaj të cilëve ka paraqitur ankesën.

¹³ Referuar kërkesave të bëra dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, minuta 31.30.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri, arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komisionit të Posaçëm për Dhënien e Licencave Profesionale, pranë MIE dhe Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, kundrejt subjektit ankues, për shkaqet e pretenduara prej tij.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, “Urdhri Profesional Hidroteknik” për shkaqet e pretenduara, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komisionit të Posaçëm për Dhënien e Licencave Profesionale, pranë MIE dhe Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, në fushën e të mirave dhe shërbimeve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA